



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1340/1 Prot.

Tiranë, më 08.11.2024

VENDIM

Nr. 26, datë 08.11.2024

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2340 Prot., datë 31.10.2024, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Vlorë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet emailit datë 25.08.2024, depozituar në adresën elektronike të koordinatores për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik desilda.caci@vlora.gov.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, lidhur me:

- Projektin se ku do të jetë ndriçimi duke vendosur tabelën sipas ligjit për këtë investim publik, shoqërinë që kryhen këto punime, supervisorin, lejen e ndërtimit, financimin se nga vjen dhe të gjithë të dhënat e detyrueshme.*
- Kontratën dhe elementët teknik të saj.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e

kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstatoi se, ankesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën 2, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, (në vijim “LDI”), i cili parashikon se: “1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit”. Konkretisht, rezulton se, kërkesa për informacion është depozituar pranë Autoritetit Publik në datë 25.08.2024, ndërkohë, ankesa ndaj këtij të fundit është paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit në datën 31.10.2024.

Në këto kushte, ankesa ndaj Autoritetit Publik rezulton e depozituar përtej afatit ligjor të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën ‘a’, ‘i’ të pikës 5 të nenit 24, ku citohet se: “5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos: a) mospranimin e ankesës kur: i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;...” dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 2340 Prot., datë 31.10.2024 të z. , kundër Autoritetit Publik/Bashkia Vlorë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi pala ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 08.11.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Konceptoi: L.Lloja

Miratoi: E. Hoxhaj